
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: 07.04.2025

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje ushqimi për bagëti (koncentrat) rezervë shteti për nevoja të DPRMSH”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Ushqime kafshësh: 15700000-5.

Vlera e fondit limit: 3,416,667 (tre milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. OE duhet te paraqese vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë liçencë të vlefshme me kodin **II.1.A.2**, për kategorinë “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren për ushqim”.

Argumentim: Kërkesa për paraqitjen e liçensës së mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 40, pika 8 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencën përkatëse lidhur me veprimtarinë për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku merr përsipër se malli objekt prokurimi do të depozitohet për ruajtje dhe do të transportohet sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në shtojcën Nr. 6 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se depozitimi për ruajtje dhe transporti i mallit do të realizohen sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor përfitues.

4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 1 (një)** automjet (jo frigoriferik) për transportin e mallrave objekt prokurimi, të cilin duhet ta ketë në pronësi, me qira ose në përdorim sipas rregullimeve ligjore. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë si :

- a. Akti që vërteton pronësinë ose Kontratë qeraje apo përdorimi (e vlefshme),
- b. Leje qarkullimi,
- c. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm),
- d. Sigurimin e detyrueshëm të mjetit (e vlefshëm).

e. Fotografi te mjetit ku te evidentohet targa.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesit e kualifikuar si te sukseshem, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetin e transportit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas specifikimeve teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR ARTIKULLIN “USHQIM PËR BAGËTI”

Ushqime për kafshë:

- USHQIM I KONCENTRUAR (KONCENTRAT) PËR KAFSHËT
- Ushqim i koncentruar (koncentrat) për bagëti.

Klasifikimi: Ushqimi i koncentruar bazë me përmbajtje drithi: misër, grurë, elb, tërshër, thekër etj, himet e grurit, përbërës mineralë dhe vitaminat, për kafshët.

1-TREGUESIT SHQISORË:

Pamja e jashtme: Karakteristikat e përbërësve që marrin pjesë në koncentrat.

Ngjyra: Të mbizotëroj ngjyra e përbërësit me përqindje peshë më të lartë. E bardhë e hirtë në të kuqërremtë, në varësi të llojit të drithit, për ushqimin për kafshë.

Era dhe shija:

- Karakteristikë e llojit të drithit: pa shije të thartë, të hidhur, pa erë myku dhe erë tjetër të huaj.
- Lëndë të huaja, nuk lejohen.

2 - TREGUESIT FIZIKO-KIMIK:

- Lageshtia/lënda e thatë jo më e vogël se 12.5%;
- Përcaktimi i fibrave jo më e madhe se 10%
- Përcaktimi i yndyrnave jo më e madhe se 8%
- Përcaktimi i Proteinave 8-24%
- Hiri jo më e madhe se 8%
- Përcaktimi i karbohidrateve jo më e vogël se 0 %
- Përcaktimi i vlerave energjitike jo më e vogël se 0 %
- Numërimi i Koliformeve totale në 30°C jo më e vogël se 10 cfu/ gr
- Numërimi i Escherichia coli betaglucoronida-positive jo më e vogël se 10 cfu/ gr

3 – VERFIKIMI I KËRKESAVE CILËSORE:

Raport-analiza fiziko-kimike e paraqitur duhet të kryhet në laborator të akredituar dhe duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

4 – AMBALAZHIMI:

Koncentrati të jetë i ambalazhuar në thasë letre ose plastmasi me masë 20-50 kg të qepur në grykë.

Thasët të jenë të pastër dhe të thatë, shmangiet në masë lejohen $\pm 0.5\text{kg}$.

Kërkesat që duhet të plotësohen për etiketimin e ushqimeve të blegtorisë janë si më poshtë:

Për ushqimet e ambalazhuar në thasë, në etiketë të shkruhet në gjuhën shqipe, të jetë e dallueshme, e lexueshme dhe e kuptueshme dhe në të të jenë shënuar;

- Emri dhe adresa e prodhuesit ose e personit përgjegjës për shpërndarjen e ushqimit;
- Numri dhe data e licencës;

- Emri i produktit;
- Emri dhe përbërja në % e të gjithë komponentëve (misër, grurë, elb, tërshër, thekër etj, himet e grurit, përbërës mineralë dhe vitaminat);
- Dpecia, grupmosha dhe rendimenti i kafshëve, për të cilat destinohet ushqimi përkatës, si dhe dozat e përdorimit;
- Data e prodhimit dhe afati kohor i përdorimit, nga data e prodhimit është deri në 6 muaj;
- Çdo kusht i veçantë i ruajtjes.

5 - RUAJTJA:

Koncentrati do të vendoset në depo të pastra e të dezinfektuar, të izoluar nga lagështira, të ajrosura të errëta, dhe pa erë të huaj.

Depozitimi i koncentratit duhet të jetë të ambalazhuar në thasë e të bëhet në stiva. Thasët duhet të vendosen në stivë njëri mbi tjetrin në formë kryqi, jo më shumë se 10 thasë në kohë vere dhe jo më shumë se 12 thasë në kohë dimri. Stivat të ndahen njëra nga tjetra me korridore të ngushta 50-60 cm dhe larg nga muri 40-50 cm.

6 - TRANSPORTIMI:

Transportimi i koncentratit, duhet të bëhet i ambalazhuar në thasë. Mjetet e transportit duhet të jenë të pastra, pa erë të huaj, lëndë toksike ose helme, si erë karburanti, kimikate të tjera. Në rastet e karrocërës mjeti duhet të jetë i pajisur me mushama për mbrojtjen e koncentratit në kohë shiu nga lagështira.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për mallin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT